



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:073240

Datë: 07.05.2019

Numri i dokumentit: 00302886

PKR.nr.29/19

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues Islam Thaçi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Zahide Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurve: I. A., për shkak të veprave penale: shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par. 8, 7, 6 e lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe G. A., për shkak të veprave penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.I.nr.12/2019, të datës 22.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.16.04.2019, në prani të palëve, shpalli publikisht, ndërsa më 07.05.2019, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit :

- 1. I. A.**, nga baba dhe nëna, e lindur, i lindur më në fshatin Sadovinë e Qerkezëve, Komuna e Vitisë, ku edhe jeton, i martuar, prind i pesë fëmijëve, i pashkolluar, din nga pak shkrim lexim, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. të letërnjoftimit me nr të tel.045-....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. G. A.**, nga baba dhe nëna, e gjinisë, i lindur me dt., në fshatin Beguncë, Komuna e Vitisë, ku edhe jeton, i pamartuar ka të kryer shkollën fillore, i papunësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, me nr.personal, me nr.tel. 044-....., shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

I

Sepse i pandehuri I. A., me dt 17.01.2019, rreth orës 14:30 në fshatin Sadovinë e Qerkezëve, komuna e Vitisë, në shtëpinë e vëllait të tij I. A., i pandehuri nga pakujdeesia ka shkaktuar rrezik të madhë për jetën e njerëzve, në atë mënyrë që : i pajisur me armën e markës Vzor 50 e kalibrit 7.65 mm, gjersa ishte në dhomë të ditës me të dëmtuarin S. B. (baxhanaku i vëllaut të tij), dhe një grumbull i madh i njerëzve, gjatë një ahengu familjar në fejesën e djalit të vëllait të tij, i pandehuri nxjerr nga brezi armën në fjalë, shkrep me armë brenda në dhomën e ndejës dhe si pasojë e shkrepjes me armë i pandehuri ka goditur të dëmtuarin një herë me një predhë në krahun e majtë dhe në pjesën e pasme të shpatullës së majtë, me ç'rast të dëmtuarit i shkaktohen lëndime të rënda trupore, i cili dërgohet për tretman mjekësor në Spitalin Regjional të Gjilanit.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.8,7,6, e lidhur me par.1 të KPRK-së.

II

Me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin I të këtij akti akuzues , i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armën zjarrtë dhe atë një armë të markës Vzor 50 e kalibrit 7.65 mm ,me nr.serik.C36497, ku nga ana e Njësisë së Hetimeve Rajonale në Gjilan arma në fjalë sekuestrohet.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

III

Sepse i pandehuri G. A. , me dt 17.01.2019, rreth orës 12:30 h , në fshatin Sadovinë e Çerkezëve , Komuna e Vitisë, në shtëpinë e dajës së tij I. A., i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrtë të markës Vzor 50 e kalibrit 7.65 mm , me nr .serik C36497, pronë e të pandehurit I. A..

Me këtë veprim ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

IV

Me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin I të aktakuzës, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, i pandehuri e ka përdorur armën e zjarrtë të markës Vzor 50 e kalibrit. 7.65 mm , me nr. serik C36497, ka dalë në oborrin e shtëpisë ku ka shtënë disa herë në ajër.

Me çka ka kryer veprën penale , përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e sipërtheksuara ligjore si dhe neneve: 4,7,17, 41, 42, 43, 46, 51, 52, 53, 73, 74, 75, 76 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPRK-së, të pandehurit,i

GJYKON

1.Të pandehurin I. A., për veprën penale dispozitivi I i aktakuzës, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti , i cili dënim nuk do të ekzekutohet , nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) viteve , nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi , nuk kryen vepër tjetër penale , në të kundërtën dënimi me kusht do t'i revokohet.

Për veprën penale dispozitivi II i aktakuzës , dënim me gjobë në shumën prej 800€ (tetëqindë) Euro, të cilën i pandehuri detyrohet që t'a paguaj na afat prej 3 (tre) muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

2.Të pandehurin G. A., për veprën penale dispozitivi III i aktakuzës , dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind) Euro , të cilën i pandehuri detyrohet që t'a paguaj në afat prej 3 (tre) muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Për veprën penale dispozitivi IV i aktakuzës, dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve , i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit , nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t'iu revokuar.

Të pandehurit pagesën e gjobës në shumën si më lartë, secili prej tyre veq e veq, duhet t'a bëjnë në afta prej 3 (tre) muajve në këste të barabarta mujore edhe atë duke filluar nga java e parë e muajit vijues- pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë ose nuk mund t'a paguajnë gjobën e caktuar me këtë aktgjykim, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'iu zëvendësoi në dënimin me burgim , duke u llagaritur 1 (një) ditë burgim me 20€ (njëzet) Euro gjobë .

Detyrohen të pandehurit që secili prej tyre veq e veq, që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 € (njëzet) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës se prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Të pandehurit I. A. i konfiskohet arma e markës Vzor 50 e kalibrit 7.65 mm ,me nr.serik.C36497.

I dëmtuari S. B. nga fshati Karaqevë e Epërme, komuna e Kamenicës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Gjilan-Deparatamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën, PP.I.nr.12/2019, të datës 22.02.2019, kundër të pandehurve: I. A., për shkak të veprave penale: shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.8,7,6 e lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, si dhe G. A. për shkak të veprave penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 i KPRK-së .

Gjykata me datë 16.04.2019, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezentuar: prokurori shtetit, të pandehurit: I. A. dhe G. A. me mbrojtësit e tyre.

Në këtë seancë i pandehuri I. A., pas leximit të aktaktakuzës nga ana e prokurorit ka deklaruar se e kam kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohem dhe se e pranoj fajësinë për kryerjen e tyre, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 paragrafi 1 të KPRK-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda më datën 22.02.2019, sa i përket të pandehurit G. A., ka paraqitur marrëveshjen për praninë të fajësisë, të nënshkruar nga prokurori i shtetit Agron Uka, i akuzuari G. A. me mbrojtësen e tij, av.Lirije Kovani.

Prokurori i shtetit, ka deklaruar se kemi pranuar kërkesën për fillimin e negociimit për praninë e fajësisë më datën 22.02.2019, pastaj kemi marrë autorizim nga Kryeprokurori i Prokurorisë së Shtetit të PTHDKR në Gjilan, Jetish Maloku dhe kemi filluar të negociojmë me të pandehurin e sipërtheksuar si dhe mbrojtësen e tij, kështu që është arritur marrëveshja për praninë e fajësisë.

Prandaj mbetem në tërësi pranë marrëveshjes për praninë e fajësisë nga ana e të pandehurit G. A., për kryerjen e veprave penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.I.nr.12/2019, të datës 22.02.2019, nga se janë plotësuar kushtet ligjore në pajtim me nenin 233 të Kodit të Procedurës Penale, duke pasur parasysh edhe caktimin e dënimit , i cili dënim është paraparë në marrëveshje.

Mbrojtësja e të pandehurit G. A. av. Lirije Kovani, ka deklaruar se pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin tim është arritur marrëveshja për praninë e fajësisë, me të cilin është rekomanduar edhe dënimi, andaj i propozojmë gjykatës që këtë marrëveshje ta pranojë ,

sepse e njejta është lidhur në përputhje me dispozitat ligjore, prandaj kërkoj nga gjykata që e njejta të aprovohet si e tillë.

I pandehuri G. A. ka deklaruar: në tërësi e mbështes deklaratën e mbrojtëses time, nga fakti se edhe unë jam dakorduar për marrëveshjen e arritur të cilën edhe e kam nënshkruar.

Pas dëgjimit të deklaratave të palëve, e në mbështetje të nenit 233 paragrafi 21, lidhur me nenin 18 të KPPRK-së, kryetari i trupit gjykues konstatoi se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, andaj vendosi që të pranohet marrëveshja për pranim të fajësisë, lidhur mes PTHDKR, në njërën anë, dhe të pandehurit G. A. me mbrojtësen e tij, në anën tjetër për kryerjen e veprave penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 i KPRK-së.

Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe duke vepruar në bazë të nenit 233 paragrafi 21, të KPPRK-së, vendosi që data e sotme, të jetë data kur palët t'i japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin, e që një gjë e tillë është bërë menjëherë.

Prokurori i shtetit Shaban Spahiu ka deklaruar: i propozoj gjykatës që marrëveshjen e dorëzuar në gjykatë, me numër dhe datë të shënuar si më lartë ta aprovtoj si të tillë duke e pasur parasysh edhe marrëveshjen lidhur me caktimin e dënimit.

Mbrojtësja e të pandehurit G. A., av.Lirije Kovani, ka deklaruar: mbetem në tërësi pranë propozimit të lartëcekur, që gjykata të pandehurit t'ia shqipton dënimin e rekomanduar me marrëveshje, dhe atë duke konsideruar se një dënim i tillë është i mjaftushëm për të arritur qëllimin e dënimit.

Pas pranimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë për veprën penale të përshkruara si në dispozitiv të aktakuzës me numër dhe datë të shënuar si më lartë, si dhe deklaratave të palëve lidhur me dënimin, gjykata të pandehurin, e shpalli fajtor dhe në pajtim me nenin 233 paragrafi 21, i'u shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket të pandehurit

Me dënimin e shqiptuar për të akuzuarin, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit, ashtu që të njëjtin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra të tjera penale dhe se ky dënim do të ndikoj edhe tek qytetarët e tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPPK-së.

Për taksën në emër të kompensimit të viktimave të krimit, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 39 par.3 nënpar. 3.2 të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, nr.05/L-036.

Me sa u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr. 215/18, më 07.05.2019

Zyrtarja ligjore,
Zaide Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues
Islam Thaçi

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.